



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
Kryesia

Nr. 237 prot.

Tiranë, më 09.03.2020

Urdhër

Nr. 10 datë 09.03.2020

Për numerizimin e periodikëve shkencorë të Akademisë së
Shkencave

Në zbatim të prioritetit të reformës institucionale të Akademisë së Shkencave (ASHSH) për një hapje të gjerë ndaj botës akademike-universitare dhe referuar pikës 19 të protokollit të bashkëpunimit midis ASHSH dhe ASHAK për periudhën 2020-2021, për një platformë të përbashkët për qasje të hapur në botimet dhe periodikët shkencorë,

Urdhëroj:

1. Nisjen e menjëhershme të procesit të numerizimit të periodikëve shkencorë të ASHSH *Studia Albanica* dhe *JNTS*;
2. Brenda 6-mujorit të parë të jenë të këshillueshëm lirisht online në faqen zyrtare të ASHSH gjithë numrat e dy periodikëve nga viti 2000 e në vijim;
3. Deri në fund të vitit 2020 të ketë përfunduar në tërësi ky proces për dy periodikët, prej numrit të parë (*Studia Albanica*, 1964; *Albanian journal of natural & technical sciences*, 1996);
4. Të vazhdojë procesi i numerizimit për veprat themelore në albanologji, sipas vendimeve që do të merren nga këshilli i botimeve;

5. Për plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga pika 19 e protokollit të bashkëpunimit me ASHAK bashkërendimi i punës të bëhet nga kryetarët e seksioneve dhe sekretari shkencor;
 6. Sektori i botimeve dhe bibliotekës të propozojë deri më 25 mars 2020 shtesat e mundshme materiale dhe njerëzore për procesin e numerizimit;
 7. Sektori i financës të përlllogarisë dhe të propozojë preventivin e procesit deri në fund të muajit mars 2020;
 8. Ngarkohen kryetarët e seksioneve, shefat e sektorëve dhe sekretari shkencor për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në veprim menjëherë.

Akademik Skënder GJINUSHI



KRYETAR